## VII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Përgatitja e këtij projektligji, është bërë nga ekspertët e IFC, bazuar në marrëveshjen e konsulencës së nënshkruar me Ministrinë e Drejtësisë. Projektligji në fazën e parë është konsultuar me një listë të gjerë aktorësh si:

- ministritë e linjës;
- gjyqtarë;
- FMN;
- Shoqatën Shqiptare të Bankave;
- Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
- Këshillin e Investimeve;
- Administratorë të falimentit;
- Shoqata e Ekspertëve Kontabël;
- Agjencia e Mbikëqyrjes Financiare;
- Euralius;

Dok 1

**LIGJ**
**Nr. 110/2016**

**PËR FALIMENTIMIN**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

PJESA E PESTË
RIORGANIZIMI DHE REHABILITIMI I PËRSHPEJTUAR

KREU I
RIORGANIZIMI

Neni 96
**Dorëzimi i planit të riorganizimit**

1. Administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës, dhe kreditorët që kanë pretendime që përfaqësojnë 20 për qind ose më shumë të shumës totale të pretendimeve, kanë të drejtë të paraqesin një plan riorganizimi në gjykatën e falimentimit brenda 1 muaji nga data e mbledhjes së raportimit, e cila vendosi për riorganizimin e debitorit.

2. Debitori mund të paraqesë, menjëherë ose në çdo kohë, një plan riorganizimi së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës së falimentimit, brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

3. Në qoftë se mbledhja e kreditorëve, sipas nenit 94, të këtij ligji, i ka kërkuar administratorit të falimentimit ose atij mbikëqyrës për të zhvilluar një plan riorganizimi gjatë përgatitjes së planit, administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës duhet të shqyrtojë rekomandimet nga kreditorët dhe debitori, në rast se ka të tilla.

4. Nëse debitori ka paraqitur një plan brenda 12 muajve të mëparshëm, i cili është refuzuar nga palët ose është tërhequr nga vetë debitori pas publikimit të datës së diskutimit në mbledhje, gjykata e falimentimit refuzon pranimin e një plani të ri nga debitori nëse një refuzim i tillë kërkohet nga administratori i falimentimit ose nga komiteti i kreditorëve, nëse është caktuar një i tillë.

Neni 97
**Informacioni mbi planin e riorganizimit**

1. Plani i riorganizimit i paraqitet gjykatës së falimentimit.

2. Gjykata e falimentimit ia paraqet menjëherë planin për komente:

a) komitetit të kreditorëve, nëse është caktuar, dhe organit përfaqësues të punonjësve, nëse ka;

b) debitorit, kur plani është paraqitur nga administratori i falimentimit ose ai mbikëqyrës ose kreditorët;

c) administratorit të falimentimit ose atij mbikëqyrës, kur plani është paraqitur nga debitori ose kreditorët.

3. Gjykata e falimentimit cakton një afat prej 10 ditësh nga momenti i njoftimit për paraqitjen e komenteve nga subjektet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni.

4. Paraqitja e komenteve për planin është e detyrueshme për komitetin e kreditorëve dhe administratorin e falimentimit ose atë mbikëqyrës. Administratori i falimentimit ose administratori mbikëqyrës paraqet opinionin e tij për qëndrueshmërinë e aktivitetit si pasojë e zbatimit të planit, si dhe

## EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "PERSON FIZIK"

### GJENDJA E REGJISTRIMIT FILLESTAR

| | |
|---|---|
| 1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NUIS) | L22208011J |
| 2. Emri i subjektit | Lindita Kikino |
| 3. Forma ligjore | Person Fizik |
| 4. Data e regjistrimit | 08/10/2012 |
| 5. Fusha e veprimtarisë | Administrator Falimenti. Aktivitete ne fushen e gastronomise. Sherbime kontabiliteti dhe konsulence financiare. |
| 6. Vendi i ushtrimit të aktivitetit | Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.9, Rruga Jordan Misja, Pallati SARA-EL, Shkalla 1, Apartamenti 2 |
| 7. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit | |
| 8. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht | Emri Tregtar: Lindita Kikino<br>E-Mail: lidakikino@gmail.com<br>Telefon: 0695510180 |
| 9. Statusi | Aktiv |

bje nga web

2

Iga ana tjetër eksperti i caktuar nga IFC për ligjin e falimentimit, avokati Vangjel Kosta, nga v 011 është pjesë e zyrës juridike "Zaka, Kosta & Memishaj" me Nipt L11806020N. Avokat ryesore e zyrës është Tefta Zaka, një ish-gjyqtare e Gjykatës së Lartë dhe bashkëshorte e Isma Iulletit. "Il Mulleti" njihet nga media si një lidhje e fortë e Familjes Berisha dhe bizneset ërbashkëta e të shumta që menexhohen pikërisht nga ky bisnesmen. Porti i ri në Porto Romar u qeveria detyrohet të bashkëpunojë me pronarët e tokave në zonën e projektuar ku të ndërtohe

KÜRÜM INTERNATIONAL SH.A.

**VENDIM datë 26.12.2018**
**I ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME TË AKSIONARËVE**
**TË SHOQËRISË TREGTARE**
**"KURUM INTERNATIONAL" SHA**

Sot, më datë 26.12.2018, u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të kësaj shoqërie me këtë rend dite:

1- *Shqyrtimi i veprimtarisë së administrimit të shoqërisë "Kurum International" SHA;*
2- *Caktimin e administratorit të shoqërisë;*

Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë aksionarët si më poshtë:

1. Znj. Selin KURUM BARLAS, e cila zotëron 3 432 400,00 aksione ose 50 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë tregtare "Kurum International" SHA;
2. Znj. Melis KURUM e cila zotëron 3 432 400, 00 aksione ose 50 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë tregtare "Kurum International" SHA;

3

Asambleja e Përgjithshme, pasi u njoh me aktet e sjella nga Administratori i shoqërisë "Kurum International" SHA,

## VËREN

Me Vendimin Nr. 6631 Akti datë 15.04.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin Nr. 603 datë 18.09.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë, është vendosur ndër të tjera hapja e procedurës së falimentimit me riorganizim të shoqërisë tregtare "Kurum International" SHA, ku është autorizuar dhe lejuar që kjo shoqëri të vetë administrojë dhe disponojë pasuritë e masës së falimentimit nën mbikëqyrjen e administratorit të falimentimit si dhe caktimin me statusin e Mbikëqyrëses, administratoren e falimentimit znj. Lindita KIKINO. Ky vendim rezulton të jetë depozituar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Me Vendimin Nr. 6631/1112 datë 30.06.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin Nr. 297 datë 19.02.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton se është miratuar plani i riorganizimit të shoqërisë tregtare "Kurum International" SHA në falimentim me organizim. Ky vendim, rezulton që të jetë i depozituar edhe pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Sipas Planit të Riorganizimit, por edhe sipas përmbajtjes së vetë vendimit Nr. 6631/1112 datë 30.06.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin Nr. 297 datë 19.02.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë, shoqëria "Kurum International" SHA, gëzon të drejtën e vetëadministrimit sipas kushteve të vendosura në këtë vendim.

Rezulton se, në zbatim të vendimit 6631/1112 datë 30.06.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me Vendimin Nr. 297 datë 19.02.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke qenë se "Kurum International" SHA, gëzonte të drejtën e vetëadministrimit, me Vendimin e saj të datës 02.08.2017, lejoi vazhdimin e z. Yusuf Sezai KURUM në detyrën e administratorit të shoqërisë "Kurum International" SHA, duke përcaktuar qartë se shoqëria në zbatim të vendimit të sipërcituar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, do të vazhdonte vetëadministrimin dhe administrator do të vazhdonte të ishte z. Yusuf Sezai KURUM. Ky vendim i Asamblesë së Përgjithshme rezulton të jetë i depozituar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

## 18. Huatë

Huate sipas maturitetit analizohen si me poshtë:

| | 31 dhjetor 2023 | 31 dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| **Huatë afatgjata** | | |
| Hua afatgjatë nga bankat | 2,357,606,988 | 10,431,023,146 |
| **Huatë afatshkurtra** | | |
| Hua afatshkurtër nga bankat | 1,146,435,834 | 2,279,510,382 |
| **Totali** | **3,504,042,822** | **12,710,533,528** |

Huatë sipas monedhës analizohen si me poshtë:

| | 31 dhjetor 2023 | 31 dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| **Huatë** | | |
| Në Lek | 0 | 16,247,676 |
| Në Euro | 3,504,042,822 | 10,546,535,724 |
| Në USD | 0 | 2,147,750,128 |
| **Totali** | **3,504,042,822** | **12,710,533,528** |

Bazuar në Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 30 qershor 2016 "Për miratimin e planit të riorganizimit", kërkesat e kreditorëve janë pranuar. Sipas planit, huatë e Shoqërisë ndaj kreditorëve të siguruar do të mbartin një normë interesi prej 5.3%, respektivisht për huatë ndaj International Financial Corporation ("IFC"), të tipit sindikatë (kredi ndaj Bankës Kombëtare Tregtare ("BKT") dhe Raiffesisen Bank), dhe 5.1% ndaj Black Sea Trading and Development Bank.

Kredite pas miratimit të planit të riorganizimit sipas llojit te kreditorëve analizohen si më poshtë:

| | 31 dhjetor 2023 | 31 dhjetor 2022 |
|---|---|---|
| **Huatë** | | |
| Kreditore të siguruar | - | - |
| Kreditore të pasiguruar | 2,363,579,720 | 11,061,556,495 |
| Interesa te përllogaritura | 1,140,463,102 | 1,648,977,033 |
| **Total** | **3,504,042,822** | **12,710,533,528** |

KÜRÜM
INTERNATIONAL SH.A.

**V E N D I M dt. 18.07.2024**
**I ASAMBLESË SË PËRGJITHËSHME TË SHOQËRISË TREGTARE**
**"KURUM INTERNATIONAL" SHA**

Sot më datë 18 Korrik 2024, u zhvillua Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë Tregtare "KURUM INTERNATIONAL" SHA, person juridik shqiptar, me rendin e ditës si më poshtë:

- *Marrja në shqyrtim e pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2023;*

Në mbledhje është e pranishme znj. Hatice Melek KURUM, aksionare e vetme e shoqërisë, e cila zotëron 6.864.800,00 (gjashtë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind) aksione ose 100 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë tregtare "Kurum International" SHA.

Në përfundim të diskutimeve, Aksionarja e Vetme, e mbledhur në formën e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, me unanimitet:

5

**V E N D O S I:**

- Miratimin për shqyrtim të rendit të ditës;
- Miratimin e pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2023;
- Miratimin e rezultatit të vitit ushtrimor 2023, i cili përbëhet nga fitimi në shumën 4,462,168,911 (katër miliardë e katërqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e njëmbëdhjetë) ALL (Lekë);
- Do të shpërndahet divident në shumën 109,043,480 lekë;
- Ky vendim merr fuqi nga dita e sotme, si dhe për përmbajtjen e tij, bëhen shënimet përkatëse sipas ligjit dhe kryhen regjistrimet dhe depozitimet e akteve pranë Qendrës Kombëtare te Biznesit dhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Tatimpaguesit e Mëdhenj Tiranë;

**ASAMBLEJA E PËRGJITHËSHME**
**AKSIONARI I VETËM**
**Hatice Melek KURUM**

Hatice Melek Kürüm